

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



PUNIMI I DIPLOMËS - MASTER

**DALLIMI NË MES EKIPEVE FINALISTE TË KUPES BOTËRORE 2019
NË FUTBOLL PËR FEMRA NË DISA ELEMENTE TEKNIKE TË
LOJËS**

**Mentori:
Prof.Asoc.Dr.Bylbyl Sokoli**

**Kandidatja:
Blerta Guri**

Prishtinë, 2021

PËRMABJTJA

1. HYRJE	3
1.2 Hulumtimet e deritanishme.....	7
2. QËLLIMI I PUNIMIT	12
3. HIPOTEZAT THEMELORE	13
4 METODOLOGJIA E PUNËS	14
4.1 Mostra e entiteteteve	14
4.2. Ndryshoret teknike të lojës	18
4.3. Metoda e perpunimit të rezultatev	19
5. INTERPRETIMI DHE DISKUTIMI.....	20
5.1 Interpretimi i parametrave themelore statistikore	20
5.1.1 Interpretimi i parametrave themelore statistikore te ndryshoret e elementeve teknike te Ekipi finalistë Holanda	20
5.2 Korelacioni i parametrave teknik ne futbol	45
5.3 Dallimi në mes finalisteve në elemente teknik	46
5.4 Analiza regresive	54
5.5 Vërtetimi i hipotezave.....	56
6. PËRFUNDIMI	57
7. VLERA TEORIKE DHE PRAKTIKE E REZULTATEVE TË PUNIMIT.....	59
8. LITERATURA	60

1. HYRJE

Futbolli si sport numërohet në grupin e sporteve kolektive, kurse sipas lëvizjeve bien në grupin e sporteve shumë strukturale të aktiviteteve komplekse, i cili dallohet me lëvizje ciklike dhe aciklike. Është sporti më i popullarizuar në botë, kjo del nga prania e dinamikës, emocionalitetit dhe atraktivitetit si dhe shumë lëvizjeve të përbëra tekniko-taktike të cilët ndodhen në të gjitha pjesët e fushës. Futbolli si sport u paraqitë në Londër Angli me 24.01.1863. Për paraqitjen e futbollit vendimtare ishin këta faktorë: ndarja e futbollit nga ragbi, paraqitja e rregullave të shkruara nga (M.Trining), formimi i federatave të futbollit, formimi i klubeve.

Futbolli në fillet e saja ishte në një nivel të ulët. Vëmendje më e madhe gjatë lojës ju kushtua sulmit ku gati të gjithë lojtarët merrnin pjesë në sulm. Sipas të dhënave të shkruara sistemi i parë u paraqitë në Angli me renditje 1-1-9. Ky sistem kishte 9 lojtarë në sulm dhe vetëm dy në mbrojtje. Më vonë u bë tërheqja edhe e një lojtari nga sulmi në mbrojtje ku u krijua sistemi i ri, sistemi T. Këtë sistem e kanë aplikuar skotlandezët 1-1-1-8, ku një lojtarë ishte portier, një ishte mbrojtës dhe një ishte qendër mbrojtës kurse 8 ishin në sulm. Loja rregullishtpërmirësohej çka sjelli deri te paraqitja e sistemit të ri, sistemit 1-1-2-7. Me këtë u bë tërheqja edhe një lojtari nga sulmi në mbrojtje, ku një lojtar ishte qendër mbrojtës kurse 2 lojtarë ishingjysmë mbrojtës. Me rregullën e re të ofsajdit në vitin 1866 ekipi i Skotlandës në vitin 1872 bëri tërheqjen e një lojtari nga sulmi në mbrojtje, tani mbrojtja është forcuar me 2 lojtar tipik mbrojtës dhe 2 lojtar gjysmëmbrojtës (halfa) ku u krijua sistemi 1-2-2-6. Në vitin 1883 Anglia u paraqitë me sistemin piramidal, me sistemin 5 në një vijë ku u barazua numri i lojtarëve të mbrojtjes me të sulmit sistemi, 1-2-3-5 me këtë sistem u mendua se gjithçka ka marr fund se u barazuan forcat në mbrojtje dhe sulm. Në këtë sistem lojtarët e sulmit janë në një vijë, më vonë është parë dobësia e sistemit 5 në një vijë dhe është bërë tërheqja e 2 lojtarëve kah mesi i fushës, kurse në sulm mbesin 2 alot dhe qendërsulmuesi. Me këtë vendosje të lojtarëve u krijuan 4 vija. Me këtë vendosje u fitua sistemi ku, lojtarët janë të vendosur 1-2-3-2-3. Në vitin 1925 u bë ndryshimi i rregullës së ofsajdit nga ai i vitit 1869. Me këtë rregull i lejohet lojtarit të pranoj në pjesën e kundërshtarit nëse para tij ka 2 lojtar, portierin dhe një lojtarë. Rregulla e ofsajdit në masë të madhe kontriboi të paraqitet sistemi. Te ky sistem kemi tre mbrojtës, ku 2 begat kishin për detyrë ti pengonin alot e ekipit kundërshtar, me këtë sistem mbrojtja ishte njeri-njeri që do të thotë mbrojtja bëhet zonale dhe individuale, kur vendosja e lojtarëve është kështu 1-3-2-2-3. Në

kampionatin e 16-të në futboll që u mbajt në Suedi në vitin 1958 reprezentacioni i Brazilit e aplikoi sistemin 4-2-4. Në këtë sistem kemi 2 mbrojtës, 2 gjysmë mbrojtës, 2 mesfushorë dhe 4 sulmues. Të gjithë sistemet pas vitit 1958 për bazë e kanë pasur sistemin 4-2-4. Në kampionatin e 20-të botëror sistemet më të aplikuara dhe luajtura ishin 4-4-2 dhe 4-3-3.

Evulimi i mëtutjeshëm sjelli deri te paraqitja e sistemit 4-4-2, ky sistem u aplikua në Kampionatin Botëror në Angli në vitin 1966. Shumë trajner mendojnë se ky sistem është defanziv, për arsye se bëhet zvogëlimi i lojtarëve sulmues në 2, kjo nuk është e vërtet sepse në kampionatin e 20-të botëror ekipi i Italisë me këtë sistem arriti të fitoj kampionatin botëror, kurse ekipi i Brazilit tregoi futboll më ofanziv dhe kishte goditje më të mëdha në portë. Posaçërisht kur sot është shëndrruar në biznes, ka sjellë që klubet të shëndrrohen në shoqata aksionare, ku rrotullohen shuma parash astronomike në futbollin profesionalposaçërisht në Evropë.

Në mënyrë që të ketë sukses është e nevojshme edhe përgatitja e jashtëzakonshme psikologjike, e cila do të monitorojë dhe konsolidoj të gjitha këto komponente të futbollit. Hapësirë për zhvillimin e mëtejshëm të futbollit gjithësesi dhe sigurisht duhet kërkuar në kuadër të taktikës, teknikës dhe aftësive motorike, marrëdhëniet që ekzistojnë ndërmjet këtyre fushave si dhe në seleksionimin psikologjik dhe zhvillimin e metodave të përgatitjes psikologjike të futbollistëve. Futbollit bashkëkohor përbën kompleksitet të madhë dhe variabilitet të punëve motorike gjatë lojës të cilat janë të orientuara në arritjen sa më të madhe të tempos, dinamikës dhe atraktivitetit, zhvillimit optimal të personalitetit të lojtarit e me këtë edhe në sukseset sportive në gara. Suksesi në futboll është i mundur vetëm atëherë nëse në mënyrë sistematike definohen fenomenet të cilat janë të një rëndësie të veçantë primare për strukturimin e lëvizjeve themelore në lojën e futbollit, ligjshmëritë e transformimeve orientuese dhe gjeneratorët primar të aktiviteteve kineziologjike. Zhvillimi bashkëkohor i sportit gjithnjë e më tepër bazohet në hulumtimet shkencore dhe qëndrimin kibernetikë në modelimin e proceseve të trainingut sportiv. Qëndrimi i tillë kërkon zbulimin e ligjshmërive dhe lidhjeve ndërmjet fushave të ndryshme të statusit psikosomatik të cilat janë përgjegjëse ose veprojnë në ekzekutimin e detyrave të ndryshme motorike në sporte. Në kohën e sotme, niveli i arritjes në sportin kulminant aq është i lartë sa që sportistët gjatë sistemeve të përgatitjes stërvitore mund të arrijnë ose ti tejkalojnë vetëm me anë të ngritjes më të madhe të efikasitetit stërvitor. Mirëpo, rritja e efikasitetit supozohet, jo vetëm rritja e sasisë së punës, por në rend të parë organizimin më të mirë të procesit stërvitor, zgjedhja më e mirë e mjeteve dhe metodave, renditja më racionale e punës dhe çlodhjes gjatë një procesi

stërvitor, disa procese stërvitore, etapave dhe periudhave, dhe e gjithë këto pandërprerëduke u kujdesur për gjendjen e sportistit. Këto kërkesa mund të realizohen kryesisht gjatë udhëheqjes (kibernetike) optimale me proceset gjithëpërfshirëse pedagogjike në proceset stërvitore sportive. Për ta kuptuar më mirë dhe më lehtë qëndrimin kibernetikë të procesit stërvitor në kineziologji, këtë mund ta bëjmë me rastin e analizimit të aktiviteteve sportive. Ekziston mundësia që të bëhet klasifikimi i caktuar i sporteve, me ndihmën e së cilave të gjitha sportet mund ti ndajmë në numër të caktuar të grupeve të ngjashme (të përafërta), pasi që ligjshmëritë që vlejné për një grup të aktiviteteve të ngjashme ose të përafërta nuk do të thotë domosdo se duhet të vlejné për grupin tjetër. Disa aktivitete kineziologjike (sportive), të cilat në kohën e sotme kanë marr aplikim shumë të lartë ndërkombëtar, është e mundur, duke u bazuar në karakterin e aktiviteteve motorike të sportistëve, si dhe specifikat garuese ti ndajmë në pesë grupe të mëdha: Futbolli si sport numërohet në grupin e sporteve kolektive, kurse sipas lëvizjeve bien në grupin e sporteve shume strukturale të aktiviteteve komplekse, i cili dallohet me lëvizje ciklike dhe aciklike. Është sporti më i popullarizuar në botë, kjo del nga prania dinamikes, emocionalitetit, atraktivitetit si dhe shumë lëvizjeve të përbëra tekniko-taktike të cilët ndodhin në të gjitha pjesët e fushës.

Analizimi i lojës në mënyrë kompjuterike i mundëson trajnerit që të kenë informata më të mëdha për ekipin e vet, mundëson që të ketë trajneri një fotografi më të qartë për ekipin e vet. Ky program kompjuterik gjatë një ndeshje regjistron, të gjitha pasimet, goditjet në portë, driblingjet, ndërprerjet, ndërhyrjet, ofsajdët, mundëson regjistrimin e të gjitha sulmeve të çdo ekipi, përqindjen e topit gjatë ndeshjes, për çdo lojtar regjistron çdo pasim, çdo ndërhyrje të suksesshme, çdo humbje të topit për çdo lojtar.

Analiza e lojës ju shërben klubeve apo trajnerëve, për shikim të gjitha situatave të ndryshme që kanë ndodh gjatë një loje. Çka analizohet?- Analizohet a është arritur qëllimi në atë lojë, a është fituar loja apo është humbur, ku janë bërë gabimet e ekipit, në cilën pjesë të fushës, humbjet e topit, apo në cilën pjesë të fushës kundërshtari është më i rrezikshëm, në cilin element është më i fort kundërshtari, apo cilin element e ka defekt kundërshtari, çfarë sistemi të lojës luanë. Analizën e lojës e bënë trajneri çdo herë, një ditë pas ndeshjes ku analizohet kontributi i ekipës. A është arritur qëllimi që loja a është fituar apo humbur, kritikim i grupit apo lojtarit, rekostuimi i disa situatave që kanë sjellë deri te humbja, njohja e karakterit të çdo lojtari, mos barazimi i fitores me lojën e mirë dhe humbjen me lojën edobët. Asnjëherë nuk duhet lojtari të kritikohet si person por kritikohet kontributi i tij gjatë lojës, analizohen gjitha linjat dhe pozitat e

ekipës gjatë asaj ndeshje. Dhe në bazë të analizave trajneri në stërvitje i ushtron situatat e ndryshme, që të behet eliminimi i atyre gabimeve që janë paraqitur gjatë ndeshjeve të kaluara. Analizohet loja e ekipit dhe loja e ekipit kundërshtar, trajneri më shumë analizon këto elemente, dhe në cilin moment të lojës po paraqitet problemi, cilat linja janë të përfshirë në problem, në cilën pjesë të fushës paraqitet problemi, pse problemi paraqitet, cilat principe janë thyer. Teknologjitë e reja ofrojnë gjithë e më tepër sisteme – aparate, pajisje dhe metoda me të cilat mundësohet aplikimi i gjerë i njohurive bashkëkohore shkencore në praktikën e përditshme. Në këtë kuptim, rëndësi të veçantë fitojnë ose kanë metodat joinvazive, racionale të cilat ofrojnë informacione relevante për udhëheqje efikase me sistemet e dëshirueshme të transformimit të organizmit.

Teknologjitë e reja krijojnë bazë metodologjike sistematiko-doktrinare, materialo-teknike dhe teknologjike për avancimin e procesit stërvitor dhe efikasitetin e procesit të këndelljes. Është vështirë që saktësisht të definojnë faktorët të cilët sjellin deri tek fitorja ose humbja për shkak të natyrës së kompleksitetit të lojës së futbollit.

1.2 Hulumtimet e deritanishme

Loja me top për herë të parë e fitoi emrin futboll në shpalljen e prefektit të Londrës Fardona në vitin 1314, kur mbreti Eduardo XI e ndaloi lojën me top përshkak se krijonte shumë zhurmë në qytet, gjithashtu edhe mbretëresha Elizabeta e ndaloi lojën me top për arsye të njëjtë. Kampionatin e parë në futboll FIFA e organizoi në MONTEVIDEO - URUGUAJI, ku në këtë kampionat, kampion i botës u bë URUGUAJI.

Që nga kjo kohë më të madhe fillohet ti kushtohet rëndësi e veçant analizimit të lojës në futboll (pa aparate dhe teknika përkatëse, programe kompjuterike). Në bazë të hulumtimeve të pranishme mund të konstatohet se deri më tani janë bërë hulumtime mbi ndikimin e parametrave tekniko – taktike në suksesin e lojës në futboll. Në këtë hulumtim ne do përmendim ose do ti përfshijmë vetëm ato hulumtime që kanë lidhshmëri me temën tonë dhe me ndikimin e parametrave tekniko- taktike në lojën e futbollit .

Angelov, Kërsetv, Koen në periudhën 1973/1974 deri 1977/78, kanë kryer hulumtim në 159 ndeshje të ligës së parë të Bullgarisë, me qëllim të vërtetimit të lidhshmërisë të goditjeve në port nga afër, largësia e mesme dhe nga largësia, me rezultatin përfundimtar. Nga rezultatet e fituara autorët japin këto përfundime ; goditjen nga afër në portë kanë lidhshmëri të madhe me rezultatin e ndeshjes, goditjet nga largësia e mesme gjithashtu kanë lidhshmëri të lartë me rezultatin e ndeshjes, kurse goditjet nga largësia ka lidhshmëri negative me rezultatin e ndeshjes.

Bozhenko në vitin 1978 , ka kryer hulumtime në 60 ekipe kulminante, me qëllim të vërtetimit të përfshirjes së përqindjes të elementeve tekniko- taktike në lojën e futbollit .

Në hulumtim kanë qenë të përfshirë këto elemente tekniko- taktike:

1. pasimet e shkurta
2. pasimet e mesme
3. pasimet e gjata
4. udhëheqja e shpejt e topit dhe driblingjet
5. lufta për top në tokë
6. lufta për top në ajër
7. goditja në portë
8. pranimi i topit në prani të lojtarit kundërshtar
9. numri i faulleve

Nga rezultatet e fituara autori ka vërtetuar përfshirjen në përqindje të këtyre elementeve në lojën e futbollit:

- Pasimi i shkurt dhe i mesëm është i përfshirë me 50%
- Pasimet e gjata me 10%
- Lufta për top në tokë me 10%
- Udhëheqja e topit dhe driblingjet me 10%
- Lufta për top në ajër, goditjet në portë, pranimit i topit në prani të kundërshtarit, dhe faullat me 12% .

Ërcos në vitin 1978 ka kryer hulumtime në 38 ekipe të kampionatit botëror në Argjentinë, qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë që të vërtetohet efikasiteti i goditjeve në portë me këmbë dhe kokë të ekipet e Evropës dhe Amerikës jugore. Sipas këtij hulumtimi ekipet evropiane kanë treguar këto rezultate:

- Numri më i madh i golave janë shënuar në aksion deri në 4 kontakte në sulm,
- Goditje më të mëdha në portë kanë mundur aksione 2-3 kontakte të topit në sulm, afër 30% e aksioneve në portë kanë mbaruar me goditje të topit me kokë,
- Efikasitet të madhë kanë pasur goditjet nga largësia nga 16 metërshi.

Në vitin 1982 autorët Soryziski dhe Norek kanë bërë analizë të kampionatit botëror në futboll në Spanjë. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të shihet në cilën pjesë të lojës bien më shumë gola. Për këtë qëllim kohëzgjatja e lojës ishte ndarë në 6 faza, çdo fazë kishte 15 minuta, nga rezultatet e fituara del se më shumë gola janë shënuar në fazën e IV, V, dhe VI të lojës, do të thotë në pjesën e II të lojës . Ksionda ka bërë hulumtim në kampionatin Spanjoll, ku autori ka pasur qëllim të hulumtoj, përfshirjen e elementeve teknike-taktike dhe koeficientin e efikasitetit. Si koeficient të efikasitetit ka marrë: numrin e aksioneve ofanzive në raport me topat e humbur. Në bazë të rezultateve të fituara autori kaardhur në përfundim se:

- në një ndeshje mesatarisht duhet të kryen 15 goditje në portë,
- në një ndeshje mesatarisht duhet të kryen 45 aksione ofanzive,
- në një ndeshje duhet të humben mesatarisht 40 topa gjatë një ndeshje të lojës së futbollit,

- konstatim tjetër është se nëse luhet me kundërshtar më të dobët se vet duhet të bëhen më shumë aksione ofanzive gjatë ndeshjes, kurse kur luhet me kundërshtar për afërsisht me kualitete të njëjta duhet më shumë të drejtohem në taktikën racionale defanzive .

Në vitin 1982 është kuptuar qartë që formacioni ekzistues në futboll duhet të pësojë ndryshime e krahas kësaj edhe përcjellja e angazhimi i lojtarëve në fushë gjatë lojës . Duke u nisur nga kjo domosdoshmëri në vitin 1982 në Spanjë, FIFAmbanë një takim me qëllim të një studimi gjithëpërfshirës, pra themelimin e qendrave për analizë statistikore që janë të nevojshme për analizimin e lojës pas ndeshjes.

Aliji, I(2009) në punimin e tij theksoi se futbolla si sport numërohet në grupin e sporteve kolektive, kurse sipas lëvizjeve bien në grupin e sporteve shumë strukturale të aktiviteteve komplekse, i cili dallohet me lëvizje ciklike dhe aciklike si dhe me elemente të shumta tekniko-taktike. Të bëhet analizimi i ndikimit të disa parametrave tekniko-taktik në suksesin e lojës në futboll tek disa ekipe më të mira të tri kampionateve evropiane edhe atë: Kampionatit Italian, Gjerman dhe Anglez ishte qëllimi i këtij punimi. Për këtë qëllim mostra për këtë punim është definuar si popullatë e lojtarëve të tri shteteve pjesëmarrëse në kampionatin 2008/09. Parametrat tekniko-taktike të cilat janë nxjerrë nga lojtarët që i kanë zhvilluar 13 ekipet të tri shteteve janë: Posedimi i topit në %, pasimet e shkurta, pasimet e gjata, gjuajtjet në portë, ekzekutimet e topit pas ndërprerjeve dhe sulmet e ekipes. Shënimet ose rezultatet për qëllimet e këtij punimi janë nxjerrur nga teknologjia informative sipas programit “ turek e-spor” Përpunimi i të dhënave tregon se sukcesi i ekipës nuk varet vetëm nga kohëzgjatja e posedimit të topit, por, edhe nga elementet tjera tekniko-taktike. Nga elementet tekniko-taktike sipas rezultateve të fituar rrjedh se sukcesi i ekipës nuk varet shumë nga numri i pasimeve të ndryshme, por nga preciziteti i tyre si dhe preciziteti i ekzekutimeve të topit pas ndërprerjeve. Gjuajtjet pozitive dhe negative në drejtim të portës në mënyrë direkte ndikojnë në rezultatin përfundimtar. Sipas rezultateve të fituara në organizimin e sulmeve të suksesshme më së shumti ndikojnë rivëniet e suksesshme nga vija anësore, autat pozitiv (AUTP), dhe gjuajtjet e pasuksesshme drejt portës, gjuajtjet negative drejt portës (GJPN). Gjithashtu në masë të konsiderueshme në organizimin e suksesshëm të sulmeve të ekipës (SULE) ndikojnë si në aspektin pozitiv ashtu edhe në atë negativ edhe pasimet e shkurta të suksesshëm dhe të pasuksesshëm.

Bajrami, J. (2011) në punimin e tij të diplomës master thekson se Analizimi i parametrave tekniko-situacionale të ekipeve në lojën e futbollit është detyrë e çdo trajneri dhe hulumtuesi në mënyrë që të analizohen në hollësi shkaqet e humbjes apo fitores dhe në aspektin profesional të merren hapa të mëtejshëm në eliminimin e tyre. Qëllimi i këtij punimi ishte që të hulumtohet dhe të përshkruhet efikasiteti i ekipeve, respektivisht, efikasiteti garues i lojtarëve si dhe efikasiteti garues i ekipeve fituese në kampionatin e fundit botëror. Për këtë arsye janë formuluar dhe parashtruar tetë hipoteza. Mostra ka përfshirë 48 ekipe fituese dhe 48 ekipe humbëse. Gjithsejtë në këtë punim janë përfshirë 96 ekipe. Në këtë punim janë aplikuar 9 parametra tekniko-situacionale. Për gjitha grupet e sistemit të parametrave tekniko-situacionale janë llogaritur parametrat themelore statistikore dhe të shpërndarjes për secilën variabël, si dhe masat e asimetrisë dhe të shpërndarjes normale, analiza faktoriale dhe analiza regressive dhe analiza diskriminative T-testi. Rezultatet e fituara tregojnë se nga nëntë parametra tekniko-situacionale në katër parametra tekniko-situacionale nuk janë vërtetuar ndryshime në mes ekipeve fituese dhe humbëse edhe atë në: parametrat goditje e topit jashtë portës (GTJP), në ekzekutimin e kornereve (KORN), në pozicionet jashtë lojës (PJLO) dhe në numrin e kartonëve të verdhë (KVER).

Kapllanbegu, Xh. (2011) në punimin e tij thekson se futbollit si sport numërohet në grupin e sporteve kolektive, kurse sipas lëvizjeve merr pjesë në grupin e sporteve shumë strukturale të aktiviteteve komplekse, i cili dallohet me lëvizje ciklike dhe aciklike. Është sporti më i popullarizuar në botë, kjo del nga prania, dinamika, emocionaliteti dhe atraktiviteti si dhe shumë lëvizjeve të përbëra tekniko – taktike. Qëllimi i këtij punimi është që të bëhet analizimi i lojës dhe faktorëve të efikasitetit situacional në lojën e futbollit të ekipeve më të mira gjatë fazës së grupeve të Ligës së Kampionëve të vitit 2009/10. Për këtë qëllim janë parashtruar shtatë hipoteza. Popullata nga e cila është nxjerrë mostra për analizë në këtë punim është definuar si popullata, e ekipeve pjesëmarrës gjatë ndeshjeve të grupeve C dhe D të ligës së kampionëve në futboll saktësisht ndeshjeve të Milanit, Realit, Interit dhe Barcelonës. Për qëllimet e këtij punimi janë përfshirë edhe ekipet humbëse me qëllim të krahasimit të rezultateve. Në bazë të qëllimit dhe hipotezave të parashtruara, janë aplikuar metodat e përpunimit të rezultateve të cilat mundësojnë sigurimin e informacioneve të mjaftueshme për realizimin e qëllimit për fitore në lojën e futbollit, elementet vendimtare janë: pasimet e shkurta pozitive, gjuajtjet e sakta në portë, rivëniet pozitive fundore, përqindja e posedimit të topit dhe numri i sulmeve drejt portës.

Llagjoviq, D. (2018). Siqëllim të punimit kishte që të vërtetohet dallimi në disa elemente tekniko-taktike në mes dy ekipeve finaliste në futboll në Kampionatin Botëror në futboll Brazili 2014. Gjithashtu qëllimi sekondar do të jetë analizimi i ndikimit të disa parametrave tekniko-taktike në suksesin e lojës në futboll, sidomos ndikimi i disa parametrave tekniko-taktike te ekipet fituese (Gjermania dhe Argjentina). Në përputhje me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e rezultateve janë formuluar dhe parashtruar tetë hipoteza në mënyrë alternative. Ekipet nga e cila është nxjerrë mostra për analizë në këtë punim është definuar si popullata e lojtarëve të dy ekipeve finaliste të Kampionatit Botëror, Brazili 2014, Gjermanisë dhe Argjentinës deri në finale. Ndeshjet të cilat janë përfshirë në këtë hulumtim janë: Argjentina - Bosnja dhe Hercegovina, Argjentina – Irani, Argjentina – Irani, Argjentina – Nigeria, Argjentina – Belgjika, Argjentina – Holanda, Argjentina – Zvicra, Gjermania – Gana, Gjermania – Portugalia, Gjermania – SHBA, Gjermania – Algjeri, Gjermania – Franca, Gjermania – Franca, Gjermania – Brazili, Gjermania – Brazili, Gjermania – Argjentina. Parametrat e teknikës së lojës në këtë hulumtim, janë bërë nga matjet me anë të programit kompjuterik të 12 variablave, për 13 ndeshje të Kampionatit Botëror, Brazili 2014. Pas incizimit të ndeshjeve është bërë përpunimi i këtyre ndeshjeve në program kompjuterik “ turek e- spor”. Në këtë punim janë përfshirë këta parametra teknik të lojës: përqindja e posedimit të topit, pasimet e gjata pozitive, pasimet e gjata negative, pasimet e shkurtra pozitive, pasimet e shkurtra negative, gjuajtjet pozitive në portë, gjuajtjet negative në portë, auta – pozitiv, auta – negativ, korna, faula dhe sulmet e ekipes. Sipas rezultateve të fituara në ekipi fitues i finales së Kampionatit Botëror, Brazili 2014, ekipi i Gjermanisë dominon në të gjitha elementet tekniko-taktike, kurse ekipi humbës, ekipi i Argjentinës dominon në numrin e organizimit të sulmeve.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Në çdo lojë të futbollit në suksesin e përgjithshëm ndikojnë shumë faktorë ndër më të rëndësishmit janë: veprimet tekniko-taktike, aftësitë motorike, funksionale, kongnitive, karakteristikat antropometrike, vetit konative e tj. Lojtarët në lojën e futbollit, bashkëpunimin ndërmjet veti dhe ballafaqimin me kundërshtarin e rrisinnëpërmjet të manipulimit të topit.

Raporti i tillë ndaj topit nuk guxon të kuptohet si mjet mekanik i ndërmjetësimit në mes lojtarëve. Kjo është shprehje e një aktiviteti të caktuar dhe kreativ për arritjen e qëllimit të dëshiruar, a para së gjithash është shprehje e mendimit kolektiv, për arritjen e qëllimit të caktuar taktik. Kryerje e lëvizjeve kreative me top dhe pas topit e bëjnë fizionominë e lojës së futbollit dhe janë të karakterizuara si veprime taktiko-teknike. Shkenca ka luajtur dhe luan rolë të rëndësishëm në ndryshimin dhe në përkryerjen e procesit stërvitor në lojën e futbollit, edhe me çka vihet deri te rezultatet më të mira. Nëpërmjet hulumtimeve shkencore zbulohen faktorët të cilët në mënyrë direkte dhe indirekte ndikojnë në arritjen e rezultateve të mira.

Duke u nisur nga fakti se vlerësimet subjektive të një trajneri apo grupi ekspertësh nuk mund të nxjerrin një përfundim të sakët mbi angazhimin real të lojtarëve në fushën e futbollit gjatë ose pas ndeshjes në një ndeshje të caktuar është e nevojshme që vlerësimet mbi kontributin e lojtarëve gjatë një ndeshje futbollistike të mbështetet në teknologjinë informative bashkëkohore. Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të vërtetohet dallimi në disa elemente teknike mes dy ekipeve në finalen e Kupës Botërore 2019 në futboll për femra, Holandës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USA-s).

Qëllimi dytësor i këtij punimi është që të vërtetohet ndikimi i disa elementeve teknike në suksesin përfundimtar të lojës në futboll në finalen e Kupës Botërore 2019 në futboll për femra.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të qëllimit të parashtruar parashtrohen këto hipoteza në mënyrë alternative:

H1 – Ekipa fituese në finalen e Kupës Botërore 2019 në futboll për femra do të ketë kohë të posedimit të topit më të gjatë se sa ekipet humbëse në të gjitha ndeshjet e zhvilluara.

H2 – Ekipa fituese në finalen e Kupës Botërore 2019 në futboll për femra do të ketë numër më të madh të ekzekutimit të elementeve teknike (pasimeve të topit) se sa ekipa humbëse.

H3 – Ndryshoret predikatore (elementet teknike) do të kenë ndikim të rëndësishëm statistikor në rezultatin përfundimtar (ndryshoren kriterike - gola të shënuar).

4 METODOLOGJIA E PUNËS

4.1 Mostra e entiteteteve

Mostra e cila është nxjerrë nga popullata për analizë në këtë punim është definuar si popullata e lojtareve pjesëmarrëse në finalen e Kupës Botërore 2019 në futboll, respektivisht dy ekipeve finaliste Holandës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USA-s). Do të analizohen nga 7 ndeshje për dy ekipet finaliste, gjithsej 14 ndeshje.

Group E

Main article: 2019 FIFA Women's World Cup Group E

Pos	Team	Pld	W	D	L	GF	GA	GD	Pts	Qualification
1	Netherlands	3	3	0	0	6	2	+4	9	Advance to knockout stage
2	Canada	3	2	0	1	4	2	+2	6	
3	Cameroon	3	1	0	2	3	5	-2	3	
4	New Zealand	3	0	0	3	1	5	-4	0	
New Zealand0–1Netherlands 11 June 2019;15:00										
Netherlands3–1Cameroon 15 June 2019; 15:00										
Netherlands 2-1 Canada 20 June 2019; 18:00										

Group F


Main article: 2019 FIFA Women's World Cup Group F


Pos	Team	Pld	W	D	L	GF	GA	GD	Pts	Qualification
1	United States	3	3	0	0	18	0	+18	9	Advance to knockout stage
2	Sweden	3	2	0	1	7	3	+4	6	
3	Chile	3	1	0	2	2	5	-3	3	
4	Thailand	3	0	0	3	1	20	-19	0	
United States13–0Thailand 11 June 2019; 21:00										
United States3–0Chile 16 June 2019; 18:00										
Sweden0–2United States 20 June 2019; 21:00										

Lojrat e të tetes së finales¹




¹https://en.wikipedia.org/wiki/2019_FIFA_Women%27s_World_Cup





[29 June –
Rennes](#)

[6 July – Nice](#)



4.2. Ndryshoret teknike të lojës

Parametrat e teknikës së lojës në këtë hulumtim, janë bërë nga matjet kompjuterike të 12 ndryshoreve, për 7 ndeshje tëfinalisteve pjesëmarrëse në finalen e Kupës Botërore 2019 në futboll, SHBA dhe Holandë.

Elementet teknike të lojës:

Elementet	Akronimet
Gjuajtjet drejt portës	GJDP
Gjuajtjet brenda portës	GJPB
Golat e shënuar	GOSH
Golat e pranuar	GOPR
Posedimi i topit	POTO
Pasimet e topit	PATO
Pasimet precize	PRPA
Faultat	FAUL
Kartonët e verdh	KAKV
Kartonët e kuq	KAKU
Ofsajdët	OFSA
Kornat	KORN

4.3. Metoda e perpunimit të rezultatev

Në bazë të qëllimit dhe hipotezave të parashtruara, do të aplikohen metodat e perpunimit të rezultateve të cilat mundësojnë sigurimin e informatave të mjaftueshme për realizimin e qëllimit. Për gjitha grupet e sistemit të variablave janë llogaritur parametrat themelorë statistikorë dhe të shpërndarjes për secilën variabël, si dhe masat e asimetrisë dhe të shpërndarjes normale.

- **Vlerat minimale dhe maksimale (R.min-R.maks)**
- **Mesatarja aritmetikore (Ma)**
- **Devijimi standard(Ds)**
- **Parametrat e asimetrisë (SKEW dhe KURT)**
- **Koeficienti i variacionit Kv%**

Raportet e ndërlidhjeve ndërmjet variablave në hapësirën manifeste, si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të ndryshoreve.

Për vërtetimin e dallimeve ndërmjet ekipeve fituese dhe ekipeve humbëse në parametrat e teknikës së lojës do të aplikohet analiza e **T – testit për grupe të pavarura**.

Përpërcaktimin e nivelit të ndikimit të ndryshoreve predikatore (elementeve teknike) në ndryshoren kritere (rezultatit përfundimtar) do të aplikohet **analiza regressive** në hapësirën manifeste.

5. INTERPRETIMI DHE DISKUTIMI

5.1 Interpretimi i parametrave themelore statistikore

5.1.1 Interpretimi i parametrave themelore statistikore te ndryshoreve e elementeve teknike te Ekipi finalistë Holanda


Në tabelën 1 janë të paraqitur parametrat themelore statistikore të ndryshoreve elementeve teknike te Ekipi finalistë Holanda. Në këtë tabela janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri), shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet) dhe homogjeniteti.

Tabela 1. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve elementeve teknike te Ekipi finalistë Holanda

Holanda	N	Min	Max	Mean	Std. Dev	Skew	Kurt	Kv
GJDP	7	5	20	12.429	5.062	-0.006	-0.475	40.720
GJBP	7	1	9	4.143	2.610	0.965	1.424	62.990
GOSH	7	0	3	1.571	0.976	-0.277	0.042	62.100
GOPR	7	0	2	0.714	0.756	0.595	-0.350	105.830
POTO	7	46	70	57.286	8.577	0.027	-0.963	14.970
PATO	7	345	658	499.857	112.387	0.045	-1.269	22.480
PRPA	7	63	81	74.857	6.466	-1.058	0.693	8.640
FAUL	7	5	16	10.143	4.140	0.312	-1.741	40.820
KAVE	7	0	2	0.857	1.069	0.374	-2.800	124.730
KAKU	7	0	0	0.000	0.000	.	.	#DIV/0!
OFSA	7	0	4	1.571	1.272	1.137	1.947	80.970
KORN	7	0	8	2.714	2.752	1.222	1.865	101.370


Mesatarja aritmetikore e ndryshores ose elementit teknik gjuajtjeve ose goditjes drejt portës(GJDP) është 12.429 goditje gjatë një loje drejt portës në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale. Rezultati minimal i goditjeve drejt portës tek një ndeshje është 5.00goditje drejt portës gjatë një loje dhe ai maksimali goditjeve drejt portës tek një ndeshje është 20.00 goditje gjatë një loje drejt portës në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale. Numri i këtij elementi teknik tregon se nuk ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore teknike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të larta mbi mesatare, sepse testi i asimetrisë është negativ (hipokurtik). Futbollistët sipas ndeshjeve në bazë të këtij elementi teknik në 7 ndeshje paraqiten si grup heterogjen që e vërteton koeficienti i variacionit ($Kv=40.720$) me një numër më të madhe të rezultateve kah ato më të larta. Lakueshmëria ose animi i rezultateve (Skewness) nuk tregon për një asimetri të theksuar (-0.006) dhe konveksiteti i fituar (Kurtosis) është i sheshtë ose platokurtike (-.635).

Histogrami 1. Shpërndarja e rezultateve të gjuajtjeve ose goditjes drejt portës (GJDP)



Mesatarja aritmetikore e ndryshores ose elementit teknik gjuajtjeve ose goditjes brenda kornizës së portës (GJBP) është 4.143goditje gjatë një loje drejt portës në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale. Rezultati minimal i goditjeve brenda portës tek një ndeshje është 1.00 goditje brenda portës gjatë një loje dhe ai maksimali goditjeve brenda portës tek një ndeshje është 9.00 goditje brenda portës në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale. Numri i këtij elementi teknik tregon se nuk ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore teknike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të ulëtanën mesatare, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët sipas ndeshjeve në bazë të këtij elementi teknik në 7 ndeshje paraqiten si grup heterogjen që e vërteton koeficienti i variacionit ($K_v=62.990$) me një numër më të madhe të rezultateve kah ato më të ulëta. Lakueshmëria ose animi i rezultateve (Skewness) nuk tregon për një asimetri të theksuar (0.965) dhe konveksiteti i fituar (Kurtosis) është normal ose mezokurtik (1.424).


Histogrami 2. Shpërndarja e rezultateve të gjuajtjeve ose goditjes brenda portës (GJBP)



Mesatarja aritmetikore e ndryshores ose elementit teknik golat e shënuar (GOSH) është 1.571 golagjatë një loje në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale, që do të thotë se janë shënuar gati përafërsisht 2 gola për ndeshje. Rezultati minimal i shënimeve të golave tek një ndeshje është 0.00 golagjatë një loje dhe ai maksimali i shënimit të golave tek një ndeshje është 3.00 shënime të golavegjatë një lojenë 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale. Numri i këtij elementi teknik tregon se nuk ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore teknike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të larta mbi mesatare, sepse testi i asimetrisë është negativ (hepikurtik). Futbollistët sipas ndeshjeve në bazë të këtij elementi teknik në 7 ndeshje paraqiten si grup heterogjen që e vërteton koeficienti i variacionit ($Kv=62.100$) me një numër më të madhe të rezultateve kah ato më të larta. Lakueshmëria ose

animit të rezultateve (Skewness) nuk tregon për një asimetri të theksuar (-0.277) dhe konveksitetin e fituar (Kurtosis) është normal ose mezokurtik (0.042).


Histogrami 3. Shpërndarja e rezultateve të elementit teknik ose gola të shënuar (GOSH)



Mesatarja aritmetike e ndryshores ose elementit teknik golat e pranuar (GOPR) është 0.714 gola gjatë një loje në 7 ndeshje, përfshirë këtu edhe ndeshjen finale, që do të thotë se është pranuar gati përafërsisht 1 gol për ndeshje. Rezultati minimal i pranimit të golave tek një ndeshje është 0.00 gola dhe ai maksimal i pranimit të golave tek një ndeshje është 2.00 pranime të golave gjatë një loje në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale. Numri i këtij elementi teknik tregon se nuk ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore teknike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të ulëta nën mesatare, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët sipas ndeshjeve në bazë të këtij elementi teknik në 7 ndeshje paraqiten si grup heterogjen që e vërteton koeficienti i variacionit ($K_v=105.830$) me një

numër më të madhe të rezultateve kah ato më të larta. Lakueshmëria ose animi i rezultateve (Skewness) nuk tregon për një asimetri të theksuar (0.595) dhe konveksiteti i fituar (Kurtosis) është i sheshtë ose platokurtik (-0.350).


Histogrami 4. Shpërndarja e rezultateve të elementit teknik ose gola të pranuar (GOPR)



Mesatarja aritmetikore e ndryshores ose elementit teknik posedimi i topit (POTO) është 57.286% gjatë një loje në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale, që do të thotë se posedimi i topit është mbi mesatare. Rezultati minimal i posedimit të topit tek një ndeshje është 46.00% dhe ai maksimal i posedimit të topit tek një ndeshje është 70.00%, në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale. Numri i këtij elementi teknik tregon se nuk ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore teknike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të ulëta nën mesatare, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët sipas ndeshjeve në bazë të këtij elementi teknik në 7 ndeshje paraqiten si grup homogjen që e vërteton koeficienti i variacionit ($Kv=14.970$) me një numër më të madhe të

rezultateve kah ato më të ulëta. Lakueshmëria ose animi i rezultateve (Skewness) nuk tregon për një asimetri të theksuar (0.027) dhe konveksiteti i fituar (Kurtosis) është i sheshtë ose platokurtik (-0.963).


Histogrami 5. Shpërndarja e rezultateve të elementit teknik posedimit të topit (POTO)



Mesatarja aritmetikore e ndryshores ose elementit teknik pasimi i topit (PATO) është 499.857 pasime të topitgjatë një loje në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale, që do të thotë se numri i pasimeve të topit është mbi mesatare. Rezultati minimal i pasimeve të topit tek një ndeshje është 345 pasime dhe numri maksimal i pasimeve të topit tek një ndeshje është 658 pasime të topit në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale. Numri i këtij elementi teknik tregon se nuk ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore teknike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të ulëta nën mesatare, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët sipas ndeshjeve në bazë të këtij elementi teknik në 7

ndeshje paraqiten si grup mesatarisht homogjen që e vërteton koeficienti i variacionit ($Kv=22.480$) me një numër më të madhe të rezultateve kah ato më të ulëta. Lakueshmëria ose animi i rezultateve (Skewness) nuk tregon për një asimetri të theksuar (0.045) dhe konveksiteti i fituar (Kurtosis) është i sheshtë ose platokurtik (-1.269).


Histogrami 6. Shpërndarja e rezultateve të elementit teknik pasimet e topit (PATO)



Mesatarja aritmetikore e ndryshores ose elementit teknik pasimi preciz i topit (PRPA) është 74.857% gjatë një loje në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale, që do të thotë se numri i pasimeve precize të topit është mbi mesatare. Rezultati minimal i pasimeve precize të topit tek një ndeshje është 63% pasime dhe numri maksimal i pasimeve të topit tek një ndeshje është 81% i pasimeve precize të topit në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale. Numri i këtij elementi teknik tregon se nuk ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore teknike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të larta mbi mesatare, sepse testi i asimetrisë është negativ (hipokurtik). Futbollistët sipas ndeshjeve në bazë të këtij elementi

teknik në 7 ndeshje paraqiten si grup homogjen që e vërteton koeficienti i variacionit ($K_v=8.640$) me një numër më të madhe të rezultateve kah ato më të larta. Lakueshmëria ose animi i rezultateve (Skewness) tregon për një asimetri të theksuar (-1.058) sepse është mbi zero dhe konveksiteti i fituar (Kurtosis) është normal ose mezokurtik (0.693).


Histogrami 7. Shpërndarja e rezultateve të elementit teknik pasimet e topit (PRPA)



Mesatarja aritmetikore e ndryshores ose elementit teknik faulat e shkaktuar (FAUL) është 10.143. Faulat e shkaktuar gjatë një lojënë 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale, që do të thotë se numri i faulave të shkaktuar është mbi mesatare. Numri minimal i faulave të shkaktuar tek një ndeshje është 5 faula të shkaktuar dhe numri maksimal i faulave të shkaktuar tek një ndeshje është 16 faula të shkaktuar në 7 ndeshje, përfshirë këtu edhe ndeshjen finale. Numri i këtij elementi teknik tregon se nuk ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në këtë ndryshore teknike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të ulëta nën mesatare, sepse

testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët sipas ndeshjeve në bazë të këtij elementi teknik në 7 ndeshje paraqiten si grup mesatarisht heterogjen që e vërteton koeficienti i variacionit ($Kv=40.820$) me një numër më të madhe të rezultateve kah ato më të ulëta. Lakueshmëria ose animi i rezultateve (Skewness) nuk tregon për një asimetri të theksuar (0.312) dhe konveksiteti i fituar (Kurtosis) është i sheshtë ose platokurtik (-1.741).


Histogrami 8. Shpërndarja e rezultateve të elementit teknik faulat e shkaktuar (FAUL)



Mesatarja aritmetikore e ndryshores të ndërhyrjet e ashpra të futbollistëve të sanksionuar me kartonë të verdh (KAVE) është 0.875% gjatë një loje në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale, që do të thotë se gati nga një karton i verdh për ndeshje. Rezultati minimal ndërhyrjeve të ashpra të futbollistëve të sanksionuar me kartonë të verdh tek një ndeshje është 0.00 dhe ai maksimal ndërhyrjeve të ashpra të futbollistëve të sanksionuar me kartonë të verdh tek një ndeshje është 2.0 në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale. Numri i kartonëve të verdhë tregon se nuk ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve në kartonët e verdh, si dhe

një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të ulëta nën mesatare, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët sipas ndeshjeve në bazë të kartonëve të verdhë në 7 ndeshje paraqiten si grup heterogjen që e vërteton koeficienti i variacionit ($Kv=124.730$) me një numër më të madhe të rezultateve kah ato më të ulëta. Lakueshmëria ose animi i rezultateve (Skewness) nuk tregon për një asimetri të theksuar (0.374) dhe konveksiteti i fituar (Kurtosis) është i sheshtë ose platokurtik (-2.800).


Histogrami 9. Shpërndarja e rezultateve të ndërhyrjet e ashpra të futbollistëve të sanksionuar me kartonë të verdh (KAVE)



Mesatarja aritmetikore e ndryshores pozita jashtë lojës-ofsajd (OFSA) është 1.571 gjatë një loje në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale, që do të thotë se gati nga dy pozita jashtëlojës ose ofsajdë në lojë. Numri minimalpozitave jashtëlojës ose ofsajdë në lojëtek një ndeshje është 0.00 dhe ai maksimal i pozitave jashtëlojës ose ofsajdë në lojëtek një ndeshje është 4.00 gjatë një loje në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale. Numri i pozitave jashtëlojës ose ofsajdë në lojë tregon se nuk ekziston një dallim i theksuar në mes ndeshjeve, si dhe një anim të lehtë të

rezultateve ka ato më të ulëta nën mesatare, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët sipas ndeshjeve në bazë të pozitive jashtëlojës ose ofsjadë në lojënë 7 ndeshje paraqiten si grup heterogjen që e vërteton koeficienti i variacionit ($Kv=80.970$) me një numër më të madhe të rezultateve kah ato më të ulëta. Lakueshmëria ose animi i rezultateve (Skewness) tregon për një asimetri të theksuar (1.137) dhe konveksiteti i fituar (Kurtosis) është normal ose mezokurtik (1.947).


Histogrami 10. Shpërndarja e rezultateve pozita jashtë lojës-Ofsajd (OFSA)



Mesatarja aritmetikore e ndryshores ekzekutimi i goditjeve fundore-KORNER (KORN) është 2.714 në çdo ndeshje në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale, që do të thotë se gati nga tri ekzekutime të goditjeve fundore në lojë. Numri minimal i ekzekutimi i goditjeve fundore në lojëtek një ndeshje është 0.00 dhe ai maksimal i ekzekutimit të goditjeve fundore në lojëtek një ndeshje është 8.00 gjatë një loje në 7 ndeshje përfshirë këtu edhe ndeshjen finale. Numri i ekzekutimit të goditjeve fundore në lojë tregon se nuk ekziston një dallim i theksuar në mes

ndeshjeve, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të ulëta nën mesatare, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Futbollistët sipas ndeshjeve në bazë të ekzekutimit të goditjeve fundorenëlojë në 7 ndeshje paraqiten si grup heterogjen që e vërteton koeficienti i variacionit ($Kv=101.370$) me një numër më të madhe të rezultateve kah ato më të ulëta. Lakueshmëria ose animi i rezultateve (Skewness) tregon për një asimetri të theksuar (1.222) dhe konveksiteti i fituar (Kurtosis) është normal ose mezokurtik (1.865).

Histogrami 11. Shpërndarja e rezultateve ekzekutimi i goditjeve fundore-KORNER (KORN)



5.1.2 Interpretimi i parametrave themelor statistikor të ndryshoreve të elementeve teknike të Ekipi finalist SHBA

Në tabelën 2 janë të paraqitur parametrat themelor statistikor të ndryshoreve elementeve teknike të Ekipi finalistë SHBA. Në këtë tabela janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri), shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet) dhe homogjeniteti.


Tabela 2. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve të elementeve teknike të Ekipi finalistë SHBA

SHBA	N	Min	Max	Mean	Std. Dev	Skew	Kurt	Kv
GJDP	7	10	40	18.429	11.133	1.464	1.738	60.414
GJBP	7	2	20	8.143	6.012	1.396	2.385	73.83
GOSH	7	2	13	3.714	4.112	2.602	6.812	110.695
GOPR	7	0	1	0.429	0.535	0.374	-2.8	124.713
POTO	7	38	73	56.857	13.619	-0.194	-1.369	23.953
PATO	7	291	649	464.571	137.317	0.196	-1.795	29.558
PRPA	7	64	85	75.000	8.641	-0.119	-2.25	11.521
FAUL	7	4	14	8.000	3.830	0.374	-1.122	47.871
KAVE	7	0	2	1.000	0.817	0.000	-1.2	81.65
KAKU	7	0	0	0.000	0.000	.	.	0.000
OFSA	7	0	3	2.286	1.113	-1.784	3.231	48.681
KORN	7	2	15	6.571	4.721	1.001	0.198	71.838

